

**AKTI I THEMELIMIT****DHE****STATUTI****I****LEGALSTRA SHPK**

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar si dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë:

Ortaku i Vetëm Themelues vendos të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe miraton këtë statut (më poshtë referuar si “Statuti”).

**KREU I****EMËRTIMI, FORMA LIGJORE, SELIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA****Neni 1****Emërtimi**

Emri i shoqërisë është **Legalstra** (në vijim referuar edhe si “**Shoqëria**”).

**Neni 2****Forma ligjore**

Legalstra është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (**shpk**), e themeluar, organizuar dhe që ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në vecanti me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (në vijim referuar si “Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

**Neni 3****Selia**

3.1 Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në adresën: **Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga “Ymer Kurti”, Godina Nr. 2, Hyrja 8, Kati 2, Tiranë, Shqipëri.**



- 3.2 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të hapë degë, filiale, agjenci dhe/ose zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj sa vijon:

- Ofrimin e shërbimeve ligjore dhe të konsulencës;
- Konsulencë biznesi dhe konsulencë korporatash;
- Veprimtari të tjera të lejueshme sipas legjislacioni të zbatueshëm në Shqipëri.

**Neni 5**

**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj për një periudhe kohore te pakufizuar.

**KREU II**

**KAPITALI, ORTAKU I VETËM, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT DHE  
TRANSFERIMI I KUOTAVE**

**Neni 6**

**Kapitali**

- 6.1. Kapitali i Shoqërisë është ALL 100 (njëqind lekë).
- 6.2 Kapitali është i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale ALL 100 (njëqind lekë).
- 6.2 Kuota është e transferueshme në cdo kohë dhe mund të transferohet në përputhje me kushtet e parashikimet e legjislacionit fuqi.
- 6.3 Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm është e kufizuar deri në vlerën e pashlyer të kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

**Neni 7**

**Ortaku i Vetëm**

- 7.1. Shoqëria zotërohet nga:
- **Znj. Anisa Isa**, shtetase shqiptare lindur më 14.06.1984, lindur në Tiranë, mbajtëse i pasaportës nr. BI4535428, zotëruese i **1 (një) kuote**, me vlerë **ALL 100** (njëqind lekë) që përfaqëson **100%** (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë;

- 7.2. Ortaku i Vetëm përgjigjet për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulon personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i Ortakut të Vetëm përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.

#### **Neni 8**

##### **Kontributi në kapital**

- 8.1. Kontributi në kapital i Ortakut të Vetëm ose ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Kontributet në para paguhen tërësisht dhe menjëherë.

#### **Neni 9**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 9.1 Shoqëria mund të zmadhojë në çdo kohe kapitalin e saj duke rritur vlerën e Kuotës si rrjedhojë e kontributeve në para dhe/ose natyrë, ose me cdo formë tjetër të lejuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 9.2 Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e saj, me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e përcaktuar në Ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
- 9.3 Vendimi për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar.

#### **Neni 10**

##### **Transferimi i Kuotës**

- 10.1 Këtu e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të transferohen nëpërmjet shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit dhe në cdo mënyrë tjetër të lejuar nga Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
- 10.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontrate, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

### **KREU III**

### **ORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 11**

#### **Ortaku i Vetëm**

- 11.1. Ortaku i Vetëm është organi me i larte vendimmarrës i Shoqërisë.
- 11.2. Ortaku i Vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të Shoqërisë për çështjet e mëposhtme:
- a) Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - b) Ndryshimet e Statutit;
  - c) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - d) Pjesëtimin e kuotes/ve dhe anulimin e tyre;
  - e) Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - f) Shpërndarjen e fitimeve;
  - g) Emërimin e shkarkimin e Administratorit/ëve;
  - h) Përcaktimin e të drejtave dhe detyrave të Administratorit/ëve;
  - i) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - j) Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - k) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratori përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - l) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - m) Miratimin e disponimit me me pasuri dhe asete të Shoqërisë;
  - n) Miratimin e riorganizimit, prishjes, transformimit, bashkimit me përthithje, ndarjes ose likuidimit të shoqërisë ose shndërrimin e formës ligjore të saj;
  - o) Autorizimin e nënshkrimit të kontratave afatgjata të cilat e çojnë Shoqërinë në detyrime afatgjata më shumë se 3 (tre) vjet;
  - p) Autorizon vendosjen e pengut ose barrës hipotekare mbi pasuritë e Shoqërisë;
  - q) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji ne fuqi apo Statuti.

### **Neni 12**

#### **Regjistri i Vendimeve të Ortakut të Vetëm**

- 12.1 Të gjithë vendimet e Ortakut të Vetëm për Shoqërinë regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve. Vendimet ruhen në formë fizike dhe elektronike në mënyrë që përmbajtja të jetë e pandryshueshme dhe të mos fshihet apo humbet.

### **KREU IV**

#### **ADMINISTRATORI, KOMPETENCAT**

**Neni 14**  
**Administratori**

- 14.1. Ortaku i Vetëm emëron një ose më shumë persona si Administratorë të Shoqërisë, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.
- 14.2. Ortaku i Vetëm mund të vendosë të shkarkojë Administratorin/ët në cdo moment përpara përfundimit të mandatit.
- 14.3. Administratori i parë i vetëm i Shoqërisë do të jetë:
- **Z. Den Minxhozi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 07.09.1986, mbajtës i letërnjoftimit me numër **035451692**.

**Neni 15**  
**Kompetencat**

- 15.1. Veprimtaria tregtare e Shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrrojë të gjitha kompetencat drejtuese të Shoqërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar, sa vijon:
- i. zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Ortakut të Vetëm;
  - ii. sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe standardeve të kontabilitetit të Shoqërisë;
  - iii. kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
  - iv. mirëmbajtjen e rregullt të librave kontabël dhe dokumenteve financiare të Shoqërisë;
  - v. përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
  - vi. përgatitjen ose/dhe miratimin e rregulloreve të brendshme të Shoqërisë
  - vii. kryerjen e gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
  - viii. përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit përmbledhës të Shoqërisë, raportin për ecurinë e Shoqërisë dhe ta paraqesë atë për miratim tek Ortaku i Vetëm, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
  - ix. të punësojë ose të ndërpresë marrëdhëniet e punës me punonjësit sipas politikave të biznesit të Shoqërisë;
  - x. të mbajë dhe përditësojë Regjistrin e Vendimeve sipas nenit 12 të Statutit dhe të ruajë ë dokumentacionin e detyrueshmë të Shoqërisë.
  - xi. kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligjin në fuqi si dhe në këtë Statut;
- 15.2. Është e drejta e administratorit të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kompetencat e tij, tek persona të tjerë.

- 15.3 Kompetencat dhe detyrat e mëposhtme do të ushtrohen nga administratori vetëm kur ato shoqërohen me autorizimin e Ortakut të Vetëm:
- transferimi i fondeve që tejkalojnë vlerën Eur 10,000 (dhjetë mijë euro) ose kundërvlefa në monedhën e transaksionit;
  - lidhja e kontratave të kredisë që kajojnë vlerën Eur 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë euro) ose kundërvlefa në monedhën përkatëse;
  - lidhja e marrëveshjeve që përmbajnë detyrime me vlerë mi Eur 20,000 (njëzet mijë euro) për Shoqërinë, përveç marrëveshjeve të shërbimit me klientë, dhe marrëveshje me nënkontraktorë sipas marrëveshjeve të shërbimit të lidhura me klientë.

## **KREU V**

### **EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR, VITI USHTRIMOR DHE PASQYRAT FINANCIARE, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 16**

##### **Eksperti kontabël i autorizuar**

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe te dhënave kontabël te Shoqërisë do t'i besohet një ose me shume eksperteve kontabël te autorizuar.

#### **Neni 17**

##### **Viti ushtrimor dhe pasqyrat financiare**

- 17.1. Viti ushtrimor i Shoqërisë fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.
- 17.2. Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabël te autorizuar, nëse ka një te tille, miratohen nga Ortaku i Vetëm ne përputhje me ligjin e aplikueshëm.
- 17.3. Administratori përtagatit, nënshkruan dhe paraqet për miratim përfundimtar tek Ortaku i Vetëm deri më 31 Mars të cdo viti pasardhës, raportin e veprimtarisë së Shoqërisë, pasqyrat financiare për vitin paraardhës dhe cdo raport tjetër të nevojshëm.

#### **Neni 18**

##### **Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë**

- 18.1. Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit te saj.

- 18.2. Ortaku i Vetëm do të emërojë një ose me shume likuidatorë dhe të përcaktojë tagrat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 18.3. Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik vetëm për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi. Gjatë likuidimit togfjalëshi “*ne likuidim e sipër*” duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.

**KREU VI**  
**MOSMARRËVESHJET, DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**Neni 19**

**Mosmarrëveshjet**


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 20**

**Dispozita përfundimtare**

Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe.

**Ortaku i Vetëm i**  
**Shoqërisë “Legalstra” sh.p.k.**

Anisa ISA   
Anisa Isa  
Datë 15/02/2021